

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ARKIVIN SHETËROR VENDOR DURRËS**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Arkivin Shtetëror Vendor Durrës, institucion i vartësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit”, për periudhën nga inspektimi i fundit deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 40, datë 30/04/2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 174/7, datë 30/04/2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Gjet Ndoj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivit të Shtetit Tiranë dhe zj. Anida Ylli, me detyrë Drejtoreshë e ASHV Durrës.

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi rezultoi se selia e ASHV Durrës përbëhet nga dy ndërtesa: ndërtesa e parë në të cilën janë vendosur zyrat e personelit ku bëhet përpunimi i dokumentacionit si dhe pritja dhe shërbimi i publikut dhe ndërtesa e dytë ku gjenden vend ruajtjet e dokumentacionit si dhe disa zyra. Ndërtesa e parë është një ndërtesë tepër e papërshtatshme e cila është e pa rikonstruktuar si dhe me kushte të papërshtatshme pune. Kati i parë ishte pa dyer të brendshme dhe nuk ishte funksional për asnjë aktivitet. Dokumentacioni i papërpunuar ruhej në dy salla të katit të dytë të kësaj ndërtesë. Në këto salla mungonin kushtet minimale tekniko – profesionale të ruajtjes së dokumenteve, si dhe për punën e vetë arkivistëve. Të dy ndërtesat janë nën ndikimin e lagështisë së përhershme, pasi ato ndodhen në nivelin e rrugës kryesore. Ky nivel bën që në kohë me shi të shkaktohen përmbytje të vazhdueshme të mjedisit përreth, i cili sjell lagështi brenda ambienteve duke shkaktuar dëmtim të dokumentacionit. ASHV Durrës kishte vendosur një sistem të mbrojtjes kundër zjarrit i cili ishte montuar dhe kolauduar, por në kohë e auditimit nuk funksiononte dhe për këtë qëllim Inspektorët e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (me poshtë PMNZSH) kishin lënë në institucion Akt Kontrollin e datës 26/12/2013. Po kështu në ndërtesën e re të ASHV, është vendosur një ashensor për lëvizjen e dokumenteve nga njëri kat në tjetrin, i cili ishte jashtë funksionit dhe sipas shpjegimeve të punonjësve nuk është vënë asnjëherë në punë që nga koha e montimit të tij nga firma ndërtuese, në kundërshtim me kërkesat e nenit 41, të ligjit nr. 9154, dt. 6.11.2003 ‘Për Arkivat’, kreu II - G “Ruajtja e Dokumenteve”, ku përcaktohen kushtet e mjedisit në arkiv në përputhje me kërkesat e teknologjisë së ruajtjes së dokumentacionit, trajtuar në faqen 10-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Për sa më sipër është rekomanduar që DPA Tiranë të marrë masat e duhura për:**

a. Rikonstrukcionin e ndërtesës së zyrave të ASHV ku bëhet përpunimi i dokumentacionit si dhe pritja dhe shërbimi i publikut dhe kthimin e tyre në ambiente të përshtatshme.

**Brenda vitit 2014**

b. Ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës për të përcaktuar masat që duhen marrë për eliminimin e lagështirës në ambientet që rrethojnë ASHV Durrës

**Brenda muajit Maj 2014**

c. Marrjen e masave të duhura për kolaudimin dhe vënien në punë të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.

**Brenda muajit Maj 2014**

d. Marrjen e masave të duhura për vënien në punë të ashensorit që shërben për lëvizjen e dokumenteve nga njëri kat në tjetrin, i cili sipas shpjegimeve të punonjësve nuk është vënë asnjëherë në punë që nga koha e montimit të tij nga firma ndërtuese

**Menjëherë**

**2.** Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me kërkesat e nenit 41, të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor;

**a.** Dritaret e vend ruajtjes së dokumentacionit të ASHV nuk ishin të siguruara me rrjeta metalike, duke u bërë shkak që elementë keqbërës mund të hyjnë lehtësisht në godinë.

**b.** Të dyja godinat e ASHV Durrës prej vitesh vazhdojnë të janë të pasiguruara me roje fizike.

**c.** Në ASHV Durrës megjithëse është instaluar një sistem alarmi ai është jashtë funksionit. Grupit të auditimit nuk ju paraqit ndonjë dokument për instalimin e tij dhe kolaudimin e herahershëm me qëllim që ai të jetë në gatishmëri.

**d.** Për shkak të sistemit elektrik të amortizuar, punonjësit e ASHV Durrës pasi kryejnë procedurat e mbylljes së strukturës janë të detyruar të ndërpresin energjinë elektrike për të evituar zjarre të mundshme. Një praktikë e tillë bën që mbas orarit zyrtar nuk janë në funksion as sistemi elektrik, sistemi i alarmit dhe ai i mbrojtjes kundër zjarrit, duke e lënë arkivin vendor jashtë çdo mbrojtje, trajtuar në faqen 12, të Projektraportit të Auditimit. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

DPA Tiranë dhe Drejtoria e ASHV Durrës të marrin masat e duhura për;

**a.** Sigurimin e dritareve të vend ruajtjes së dokumentacionit të ASHV me rrjeta metalike të sigurta që pengojnë hyrjen nga jashtë.

**b.** Për ruajtjen e ASHV Durrës me roje fizike ose sistem sigurie mbikëqyrje të lidhur me policinë për kohën kur në ambientet e punës nuk ka punonjës të institucionit.

**c.** Për kolaudimin dhe vënien në punë të sistemit të alarmit i cili është jashtë funksionit.

**Brenda muajit Qershor 2014**

**3.** Nga auditimi rezultoi se jo të gjitha ambientet ishin të pajisura me sistem kondicionimi. Në veçanti ambientet ku punojnë arkivistët dhe ku i shërbehet publikut. Aty ku mungon sistemi i kondicionimit përdoren ngrohës, krejtësisht të papërshtatshëm duke parë edhe gjendjen e raportuar të sistemit elektrik nga ana e PMNZSH-së, në kundërshtim me kërkesat e nenit 42 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, trajtuar në faqen 12, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

Nga DPA Tiranë të merren masat e duhura për vendosjen në ambientet ku punojnë arkivistët dhe ku i shërbehet publikut të kondicionerëve dhe eliminimin e ngrohësve të papërshtatshëm.

**Brenda muajit Korrik 2014**

**4.** Nga auditimi rezultoi se dizinfektimi dhe dizinsektimi i dokumenteve në ASHV Durrës nuk është kryer, në kundërshtim me kërkesat e nenit 44 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, trajtuar në faqen 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Për sa më sipër është rekomanduar që:**

Nga DPA Tiranë të merren masat e duhura për dizinfektimin dhe dizinsektimin e dokumenteve në përputhje me kërkesat e nenit 44 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

**Menjëherë**

5. Nga auditimi rezultoi se në ASHV Durrës nuk ka gjurmë akt kontrollesh të lëna nga Drejtoria e Inspektim – Kontrollit përmes inspektorëve të saj ku të parashikohen masa dhe detyra në ngarkim të punonjësve të ASHV Durrës në lidhje me metodologjinë tekniko – profesionale të ruajtjes së dokumenteve, me ruajtjen fizike të dokumenteve, me sigurimin e ndërtesave të ASHV Durrës, etj, në kundërshtim me kërkesat e Kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 04.03.2004 për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, nenet 10, 11 e 12, ku përcaktohet se: “...cakton detyra me shkrim dhe **lë akt kontrolle për mangësitë e vërejtura në punën arkivore dhe kontrollon zbatimin e tyre**”. trajtuar në faqen 18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

a. DPA Tiranë të analizojë punën e Drejtorisë së Inspektim – Kontrollit dhe të përcaktojë përgjegjësinë e tyre për mos dokumentimin e inspektimeve të kryera në përputhje me kërkesat e neneve 10, 11 e 12, të Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

b. Drejtoria e Inspektim – Kontrollit në DPA të marrë masat e duhura për kryerjen e inspektimeve dhe dokumentimin e tyre në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme të DPA Tiranë.

#### **Menjëherë**

6. Nga auditimi për realizimin e të ardhurave nga kryerja e shërbimit me dokumente për periudhën 01.01.2013 deri më datën 24.02.2014 rezultoi se, janë arkëtuar sipas mandat arkëtimeve gjithsej 640 600 lekë dhe janë derdhur në Bankën Credins, Durrës, sipas faturave të ASHV dhe sipas mandat arkëtimeve të bankës 641 700 lekë, më tepër **1100 lekë**. Nga auditimi i veprimtarisë së arkës u konstatua parregullsi që bien në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësive publike”, e përkatësisht;

a. Për derdhjen e të ardhurave të realizuara në bankë, nuk është prerë mandatpagesë, por janë plotësuar fatura të cilat janë nënshkruar nga punonjësja e ngarkuar me arkën dhe Drejtori i ASHV.

b. Për periudhën e audituar, nga DPA nuk është kontrolluar veprimtaria e të ardhurave që realizon ASHV Durrës, pasi nuk u gjend asnjë dokument që vërteton se gjendja e arkës është kontrolluar.

c. Derdhjet e mjeteve monetare në Bankën Credins janë bërë për periudha të gjata nga disa ditë deri në një muaj e gjysmë duke mbajtur shumën të konsiderueshme në kasafortë.

d. Në librin e arkës janë regjistruar vetëm mandat arkëtimet, por jo faturat dhe derdhjet në bankë e për rrjedhojë ky libër nuk është plotësuar sipas kërkesave të formatit dhe nuk ka pasqyruar gjendjen e arkës në fund të ditës, trajtuar në faqen 19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Për sa më sipër është rekomanduar që:**

Drejtorja Ekonomike e Shërbimeve dhe e Financës në DPA të marrë masat e duhura për rregullimin e aktivitetit të arkëtimin të të ardhurave nga kryerja e shërbimit me dokumente, në përputhje me pikat 62, 63, 64, 67 e 68 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësive publike”.

#### **Menjëherë**

7. Nga auditimi për verifikimin e gjendjes së inventarit për disa nga pajisjet e inventarit ekonomik rezultoi se;

a. Inventari i fundit për pajisjet e inventarit të kësaj njësie është kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Tiranë më datë 20.03.2013 dhe pas këtij date nuk ka inventar tjetër.

b. Nga 160 copë rafte metalike konstrukcion e lehtë, rezultuan 168 copë ose 8 copë më tepër në shumën 20 144 lekë. Këto rafte janë model e vjetër dhe të vendosur në dy salla në katin e II-të të ndërtesës së vjetër të ASHV.

c. Nga 15 copë rafte metalik me hele, të shënuara në inventarin e datës 20.03.2013 nuk ndodhet asnjë, me diferencë mungesë në shumën **25 320 lekë**.

d. Ne katin e I-rë dhe të II-të të ndërtesës së re të ASHV, janë vendosur raftet e lëvizshëm të mbështetur ne dy kolona fikse me përmasa 1/2 e rafteve të lëvizshëm dhe me nga 30 sergjen secila, por janë konsideruar si rafte te plota (dy kolona, 5 rafte secila me 30 sergjen secila kolonë, gjithsej 60 sergjen). Në të dy sallat janë vendosur në total 180 rafte të lëvizshëm dhe 2100 sergjen në përputhje me inventarin e datës 20.03.2013. **Për sa më sipër është rekomanduar që Drejtoria Ekonomike e Shërbimeve dhe e Financës në DPA të marrë masat e duhura për;**

a. Kryerjen e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese në përputhje me kërkesat e Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njëjësive publike”, duke përfshirë në inventarin fizik të ASHV Durrës 8 copë rafte metalik konstrukcion e lehtë të rezultuara tepër në shumën 20 144 lekë.

b. Nxjerrjen e përgjegjesisë për 15 copë rafte metalik me hele, të shënuara në inventarin e datës 20.03.2013, të deklaruara të papërdorshme, por që rezultuan mungesë në shumën 25 320 lekë.

c. Nga specialistët e DPA të bëhet verifikimi i dy kolonave fikse me përmasa 1/2 e rafteve te lëvizshëm dhe me nga 30 sergjen secila, që janë konsideruar si rafte te plota (dy kolona, 5 rafte secila me 30 sergjen secila kolonë, gjithsej 60 sergjen) në përputhje me specifikimet teknike dhe kontratën e lidhur me firmën fituese të furnizimit me rafte të lëvizshme.

**Brenda muajit Korrik 2014**

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**